



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs*

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**  
**/ Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy**  
**for Public Safety**

---

# **RAPORTI VJETOR I PUNËS**

## **AKSP - 2024**

*Vushtrri, Janar 2025*

## Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	5
MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT E AKSP-së.....	5
<b>1. BORDI I AKSP</b> .....	<b>7</b>
<b>2. ARSIMI LARTË</b> .....	<b>8</b>
<b>3. TRAJNIMET DHE PËRKRAHJA ARSIMORE</b> .....	<b>9</b>
3.1. TRAJNIMET E MBAJTURA.....	9
3.2. SHËRBIMET STUDENTORE.....	10
3.3. BIBLIOTEKA.....	10
3.4. PËRKRAHJA GJUHËSORE .....	10
3.5. KURIKULAT DHE TESTIMET .....	11
<b>4. LEGJISLACIONI DHE PLANIFIKIMI STRATEGJIK</b> .....	<b>11</b>
4.1. LEGJISLACIONI.....	11
4.2. PLANIFIKIMI STRATEGJIK.....	12
<b>5. SHËRBIMET E PËRGJITHSHME DHE FINANCAT</b> .....	<b>13</b>
5.1. BURIMET NJERZORE .....	13
5.2. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA .....	14
5.3. FINANCAT .....	15
5.4. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE.....	15
<b>6. SIGURIMI I CILËSISË</b> .....	<b>16</b>
6.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË (AKK, AKA, IADLEST) .....	17
6.2. VLERËSIMI I TRAJNIMEVE .....	18
6.3. AKTIVITETET DHE GJENDJA AKTUALE.....	18
<b>7. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....	<b>18</b>
7.1. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE .....	18
7.2. BASHKËPUNIMI ME PARTNER NDËRKOMBËTAR BRENDA VENDIT.....	19
7.3. BASHKËPUNIMI ME ASOCIACIONE DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE .....	20
7.4. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË NDRYSHME JASHTË VENDIT .....	20
<b>8. KOMUNIKIMI DHE MEDIA</b> .....	<b>22</b>
<b>9. AUDITIMI</b> .....	<b>22</b>
<b>10. PROKURIMI</b> .....	<b>23</b>

## HYRJE

Në emër të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike/ AKSP kemi kënaqësinë që përmes këtij raporti vjetor të pasqyrojmë veprimtarinë dhe aktivitetet e AKSP-së konformë obligimeve dhe detyrave të saja ligjore.

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (tutje AKSP) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Inspektorati Policor i Kosovës.

AKSP-ja të gjitha aktivitetet dhe veprimet që i ndërmerr janë të koordinuara përmes prioriteteve të MPB-së, Planit Vjetor të Punës së AKSP-së për vitin 2024 dhe Strategjisë Zhvillimore dhe Planit të Veprimit të AKSP 2023 – 2026.

Përmes këtij raportit pasqyrohet veprimtaria e AKSP-së konformë obligimeve dhe detyrave të saja ligjore duke u mbështetur në punën efektive e cila është drejtuar nga vizioni dhe misioni i saj i udhëhequr nga parimet : profesionale, transparente, etike, efektive dhe të përgjegjshme.

Të arriturat e periudhës raportuese janë si rezultat i punës së stafit të AKSP-së të cilët kanë dhënë kontributin e tyre qoftë individual apo grupor në kryerjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të plotë të detyrave të punës dhe njëkohësisht duke falënderuar për punën dhe bashkëpunimin e Institucioneve të Sigurisë Publike dhe partnerëve Ndërkombëtar të cilët kanë mbështetur AKSP-në në arritjen e sukseseve.



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Duke pasur një mision të qartë, AKSP është e përkushtuar në arsimimin dhe trajnimin e zbatuesve të ligjit në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë.

Të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë vitit 2024 të AKSP-së kanë qenë të orientuara drejt implementimit të objektivave strategjike dhe vjetore të miratuara .

Raporti ka për qëllim prezantimin e informatave dhe treguesve në implementimin e objektivave të saja për periudhën raportuese janar – dhjetor 2024.

### **Si të arritura kryesore në fusha të ndryshme brenda kësaj periudhe mund ti veçojmë:**

<b>Fusha trajnimeve</b>
Realizimi i 47 trajnimeve me gjithsej 1659 zyrtar të Institucioneve të Sigurisë Publike
Fillimi dhe Mbarimi i Trajnimeve Profesionale në AKSP: - Trajnimi Profesional "Zyrtar Korrektues" SHKK Gjenerata 44, janë diplomuar 64 zyrtarë të rinj, - Trajnimi Profesional "Polic i Ri" PK Gjeneratat 59 dhe 60 ku janë diplomuar 893 zyrtarë të rinj.
Identifikimi dhe zhvillimi i (6) trajnimeve të reja sipas nevojave të ISP-ve
Ofrimi i 3 trajnimeve online për zyrtarët e AKSP-se
<b><i>Hartimi dhe miratimi dokumenteve</i></b>
Miratimi I Udhëzues (AKSP) Nr.01/2024 për Përcaktimin e Procedurave Kundër Mashtrimit
Miratimi I Rregullore (AKSP) Nr. 02-2024 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në AKSP
Miratimi I Rregullores KF - Kundër Plagjiaturës në FSP
Miratimi i përcaktimit të procedurave për hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme në AKSP
Hartimi i Planit të Përformancës së AKSP për vitin 2025
Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit AKSP 2024-2026
Hartimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Punës dhe Listës së Rrezikut AKSP 2025
Miratimi I Planit zhvillimor të Personelit akademik FSP 2024-2026
Digjitalizimi i manualit të identitetit të AKSP
Miratimi i Planit Vjetor të Trajnimeve AKSP 2025
<b><i>Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe bashkëpunimi</i></b>
Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit mes AKSP dhe FSK me 22.02.2024
Nënshkrimi i marrëveshjes ndër-institucionale mes AKSP dhe Kolegjit AAB

Nënshkrimi i marrëveshjes ndër-institucionale mes AKSP dhe Fakultetin e Sigurisë së Shkupit të Universitetit St. Kliment Ohridski të Maqedonisë së Veriut, në kuadër të Programit Erasmus
Nënshkrimi i Marrëveshjes me Akademinë Policore të Kroacisë
Nënshkrimi i Marrëveshjes me Akademinë e Drejtësisë të Karolinës së Veriut - SHBA
<b><i>Pranimi dhe realizimi i vizitave të AKSP-së</i></b>
Vizitë nga Komponenti UNPOL i UNMIK-ut në Kosovë, udhëhequr nga znj. Krista Kimber, Këshilltare e lartë e policisë pranë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Udhëheqëse e Komponentit UNPOL të UNMIK-ut në Kosovë.
Vizitë nga EULEX në Kosovë
Vizitë nga KFOR Hungarez në Kosovë
Vizitë nga Zyra Erasmus+ në Kosovë
Vizitë nga Ministria e Punëve të Brendshme e Bullgarisë
Vizitë nga Drejtori i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë në MPJD në Kosovë
Vizitë nga Universiteti Vives i Shkencave të Aplikuara, Belgjikë
Vizitë nga zyrtarja e Punëve të Jashtme për Kosovë dhe Shqipëri, nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), departamenti i shtetit Amerikan.
Vizitës nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), departamenti i SHBA
Vizite studimore e AKSP në Akademinë e Drejtësisë së Karolinës Veriore në SHBA
Vizitë nga Fakulteti i Sigurisë i Universitetit "St. Kliment Ohridski" në Maqedoninë Veriut
Pjesëmarrja e AKSP-së në Forumin për Bashkëpunim Strategjik WB PaCT (Projekti kundër Krimit dhe Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor) që udhëhiqet nga CEPOL
Pjesëmarrja e AKSP në Konferencën Vjetore IADLES -SHBA
Vizitë nga Ekipi Ndërlidhës dy anëtarësh të KFOR-it nga Mbretëria e Bashkuar, z. Domenico Scigliano, Zyrtar Ndërlidhës i KFOR me PK-në
Vizitë nga 5 (pesë) Monitorë Udhëheqës për Tematikën të EULEX për ambient, krimet e urrejtjes, dhuna në baza gjinore dhe për policinë
Vizitë nga Programi i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar Kundër Pastrimit të Parave (AML)
Vizitë nga Ekipi Ndërlidhës dy anëtarësh i KFOR-it nga Mbretëria e Bashkuar
Pranimi i vizitës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës në AKSP
Studentët e FSP dhe stafi akademik kanë realizuar vizitën studimore në Akademinë e Sigurisë Shqipërisë për shkëmbimin e përvojave dhe mundësit e bashkëpunimit mes Institucioneve respektive
<b>Aktivitete dhe ngjarje tjera</b>
AKSP- Mbajtja e lojërave para sportive "Kosova 2024" për personat më nevoja të veçanta
Organizimi në AKSP i ditës Informuese rreth programit ERASMUS+ në bashkëpunim me Zyrën e ERASMUS+Kosovë
Pranimi donacionit nga OSBE

Tryeza shkencore - me temën „ Lehtësimi i dialogut ndërinstytucional për prezantimin e modulit të ri të hetimit të krimit mjedisor për zbatimin e ligjit dhe gjyqësorin

Mbajta e tryezës me temën “Rendi i ri botëror dhe siguria kombëtare”

## STRUKTURA ORGANIZATIVE

AKSP-ja ka të rregulluar sistemin e brendshëm të organizimit sipas Rregullore (QRK) nr. 05/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Bazuar ne Ligjin Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike personeli i AKSP-se ndahet ne: personel menaxhues; personel trajnues dhe mësimdhënës dhe personel mbështetës.

Numri i vendeve të punës me buxhet është 156. Numri aktual i të punësuarve është 126 sipas strukturës kualifikuese, etnike dhe gjinore e pasqyruar në tabelë:

Total stafi AKSP	Përbërja strukturore e stafit të AKSP									
	Ngritja profesionale			Përbërja etnike			Gjinore		Aftësi Kufizuar	
	Fakultet (tutje)	Shkollim i lartë	Shkollim i mesëm	Shqiptar	Serbë	Turk	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
126	71	1	54	121	3	2	81	45	2	0

## MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT E AKSP-së

Misioni institucional është i përcaktuar në Ligjin e AKSP-së ndërsa vizioni, vlerat dhe objektivat e AKSP-së janë të përcaktuara në dokumentin zhvillimor institucional të miratuar „ *Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të AKSP-së 2023-2026*”

**Misioni** - të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurve për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

**Vizioni** - Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballën

**Vlerat** - AKSP-ja ka përcaktuar këto vlera themelore: **ndershmëria, transparenca, përgjegjshmëria, etika profesionale dhe diversiteti.**

**Objektivat strategjike** të AKSP-së janë:



*Ngritja e kapaciteteve profesionale të institucioneve të sigurisë publike përmes ofrimit të programeve trajnuese të standardizuar*



*Avancimi i arsimit të lartë në siguri publike*



*Zhvillimi i profilit hulumtues në shërbim të sigurisë publike*



*Avancimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore në zbatimin e politikave të sigurimit të cilësisë dhe procesit të përmirësimit*



*Përmirësimi i kornizës ligjore dhe menaxhim efikas i burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe proceseve të punës në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira*



*Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe rritja e kredibilitetit të AKSP*

## 1. BORDI I AKSP

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Me qëllim të arritjes së objektivave të Akademisë dhe akordimit të politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike për Institucionet e Sigurisë Publike është paraparë edhe themelimi i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me qëllim të vendosjes së minimumit bazë të standardeve profesionale, politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike, edukimin e specializuar dhe të avancuar të zyrtarëve të Institucioneve për Siguri Publike. Bordi është i organizuar në bazë të Rregullores nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, ku me këtë rregullore përcaktohet përbërja, përgjegjësitë si dhe rregullat e punës.

Gjatë periudhës raportuese 2024 janë zhvilluar dy (2) takime të rregullta të Bordit të AKSP-së (15.05.2024 dhe 23.11.2024 ) ku edhe janë diskutuar shumë çështje me rëndësi për proceset e AKSP-së duke siguruar që të përmbushin standardet e nevojshme për të ofruar mundësi cilësore të edukimit dhe zhvillimit profesional në fushën e sigurisë publike si dhe janë nxjerrë vendime të ndryshme si vijon:

- Diskutimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Trajnimeve AKSP 2025
- Zgjedhja e kryesuesit të ri vjetor të Bordit, Ismail Dibrani Drejtor i Përgjithshëm i SHKK
- Diskutimit për zhvillimin dhe rrjedhën e trajnimeve
- Themelimi i grupit punues për Rishikimin e standardeve profesionale për 6 agjencionet e sigurisë publike
- Proceset e ri-akreditimit vendor dhe ndërkombëtar të AKSP si institucion ofrues i arsimit dhe aftësisimit profesional, etj





## 2. ARSIMI LARTË

---

Fakulteti për Siguri Publike gjatë kësaj periudhe ka pasur angazhime të shumta në funksion të realizimit të misionit të vet të përcaktuar ligjërisht. Fokusi kryesor i punës ka qenë përmbushja e angazhimeve akademike të mësimdhënies, hulumtimit dhe përcjellës së punës me student, dhe implementimi i Intershipit (periudha praktike)

**Organizimi i mësimdhënies, provimeve dhe vlerësimeve të studentëve** – Gjatë kësaj periudhës raportuese janë organizuar afatet e rregullta të provimeve sipas planifikimit për mbajtjen e tyre.

**Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor** - Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor BA në siguri Publike ka filluar dhe është në proces e sipër sipas dinamikave në zhvillim. Po ashtu Programi studimor i rishikuar do të dorëzohet tek hisedarët dhe pastaj në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës në kohën e cila është e përcaktuar për riakreditim.

**Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim (IHZH)** – ka informuar rregullisht stafit rreth ftesave për aplikim në grante, publikime, konferenca, seminare dhe punëtori me interes, Personeli akademik me marrëdhënie të rregullt pune është në vazhdimësi i angazhuar në hulumtime dhe publikime në fushat e interesit të tyre. Po ashtu ka filluar edhe hartimi i draft rregullores në lidhje me nxitjen dhe financimin e veprimtarisë hulumtuese shkencore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

**Organizimi i tryezave shkencore** –Gjatë vitit raportues janë mbajtur dy (2) tryeza shkencore si vijon:

- ✓ Tryeza shkencore I – me temën „ Lehtësimi i dialogut ndër-institucional për prezantimin e modulit të ri të hetimit të krimit mjedisor për zbatimin e ligjit dhe gjyqësorin"
- ✓ Tryeza ndërkombëtare shkencore II – me temën “ Rendi i ri Botëror dhe Siguria Kombëtare” Shoqata e Pensionistëve të TMK/FSK dhe Simpatizantëve ELITA

**Mbrojtja e Temës së Diplomës** - Gjatë periudhës raportuese në Fakultetin për Siguri Publike pas përfundimit të gjitha procedurave dhe prezantimit të punimeve kanë diplomuar gjithsej 45 studentë / zyrtarë të sigurisë publike.

### 3. TRAJNIMET DHE PËRKRAHJA ARSIMORE

Në lidhje me implementimin e trajnimeve AKSP ka pasur koordinim dhe komunikim me akterët përkatës të ISP-ve ku pas konsultimeve me ISP, partnerët ndërkombëtarë dhe Bordit të AKSP-së, Drejtori i Përgjithshëm me vendimin nr.267 të datës 14.12.2023 ka miratuar Planin Vjetor të Trajnimeve të AKSP-së për vitin 2024.

Gjate periudhës raportuese në bashkëpunim me ekspertet e fushave përkatëse të Agjencioneve është bërë zhvillimi i trajnimeve të reja sipas tabelës vijuese:

NR.	TRAJNIME TË REJA TË ZHVILLUARA
1	Trajnimi vlerësimi i dëmeve
2	Trajnimi bazik i forumeve të sigurisë për reagim emergjent
3	Trajnimi për Trajner
4	Trajnimi mbrojtja e fëmijëve nga dukurit negative
5	Trajnimi Përcjellja e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë
6	Trajnimi Menaxhimi i Zemërimit

Po ashtu gjatë këtij viti AKSP me qëllim të lehtësimit vijimin e trajnimeve për zyrtarët e sigurisë publike, ka filluar me organizimin e trajnimeve përmes platformave elektronike ku ka mbajtur (3) trajnime online (MOODLE PLATFORM).

Për avancimin e fushës së trajnimeve janë zhvilluar edhe takime të shumta me akterë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar si: PK, IPK, SHKK, SHSK, DK, AME, OSBE, KFOR FSK.

Mbështetur në Marrëveshjet e Mirëkuptimit të arritura ndërmjet AKSP-së dhe Institucioneve të Sigurisë (IPK, SHKK, SHSK, DK, AME) me qëllim të funksionalizimit të tërësishëm të tyre janë hartuar shumë dokumente të cilat pritet miratimi i tyre si vijon:

- Draft - Procedurat për angazhimin e personelit trajnues
- Draft - Politikat për vlerësimin e performancës së personelit trajnues
- Draft - Kriteret për ndarjen e trajnimeve mes AKSP-së dhe ISP-ve
- Draft - Politikat për Analizën e Nevojave për Trajnim

#### 3.1. TRAJNIMET E MBAJTURA

AKSP në kuadër të përgjegjësiive për ofrimin e trajnimeve për institucionet e sigurisë publike si dhe planit vjetor për trajnime për vitin 2024 në bashkëpunim të ngushtë me ISP-të dhe partnerët ndërkombëtar (ICITAP, OSBE) gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor ka organizuar gjithsejtë **47 trajnime me 1659 vijues të trajnimeve.**

Në vijim janë të pasqyruar numri i trajnimeve dhe numri i vijuesve sipas agjencioneve të sigurisë publike si dhe organizatave / partnerëve ndërkombëtar:

NR.	AGJENCIONET/ORGANIZATAT	NR. TRAJNIMEVE	NR. VIJUESVE
1	Policia e Kosovës	20	1169
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	9	139
3	Dogana e Kosovës	3	39
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	2	81
5	OSBE	5	94
6	Zyra e Programeve Ndërkombëtare të Shërbimit Pyjor të Departamentit të Bujqësisë së SHBA	1	18
7	Trajnimet e përbashkëta ASP	7	119
<b>Total</b>	<b>Numri i trajnimeve dhe vijuesve</b>	<b>47</b>	<b>1659</b>

### 3.2. SHËRBIMET STUDENTORE

Gjatë kësaj periudhe janë bashkërenduar punët dhe shërbimet e administratës me pjesën tjetër akademike të arsimit të lartë dhe trajnimet lidhur me menaxhimin e hapësirave mësimore, oraret e ligjëratave dhe trajnimeve, rezultatet e provimeve dhe testeve, njoftimet mbi aktivitete të tjera që ndërlidhen me AKSP-në dhe njësitë tjera, futja në sisteme dhe data baza të dhënave të vijuesve etj.

### 3.3. BIBLIOTEKA

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zbatuesve të ligjit, është punuar në krijimin e kushteve të përshtatshme të bibliotekës për nevojat e vijuesve të AKSP-së ku në këtë aspekt gjatë periudhës raportuese janë dhënë 169 libra për lexim për vijuesit e AKSP-së, në programin e bibliotekës deri më tani kemi rreth 567 anëtarë të regjistruar në bibliotekën e AKSP.

### 3.4. PËRKRAHJA GJUHËSORE

Përveç gjuhës shqipe, AKSP ofron trajnime edhe në gjuhën serbe. Po ashtu, me rastin e ofrimit të trajnimeve nga organizatat dhe institucionet e huaja në AKSP ofrohet përkthim në gjuhën angleze. Si rezultat i përgjigjes ndaj këtyre nevojave janë ofruar këto shërbime: **Shërbimet e Përkthimit në formën e shkruar** – janë proceduar **3252** faqe, ku prej tyre **1048** faqe nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas si dhe **2204** faqe nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas.

**Shërbimet e Përkthimit Verbal** – Janë mbuluar me përkthim verbal mesatarisht 2 trajnime/aktivitete për javë me përkthim verbal.

**Shërbimet e Lekturës dhe e Korrekturës** – Në bazë të kërkesave për lekturë dhe korrekturë të materialit janë lekturuar gjithsejtë **548** faqe.

### 3.5. KURIKULAT DHE TESTIMET

Në lidhje me Kurrikulat janë formatizuar gjithsej 5 trajnime ndërsa janë harmonizuar 501 mësimet/doracak. Sa i përket mbajtjes së testeve për trajnimet që i nënshtrohen testeve gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete si në vijim:

TRAJNIMET QË I JANË NËNSHTRUAR TESTIMIT			
Numri i trajnimeve	Nr. i testuarve	Ri-testim	Dështim
28	7176	415	6

### 3.6. SHËRBIMET E MULTIMEDIAS DHE FOTOKOPJËS

Gjatë periudhës së raportimit janë realizuar këto aktivitete të paraqitura si në vijim:

- Materiali i fotokopjuar 2,500,718 fletë
- Printimi me ngjyra 659 Certifikata për kurse/trajnime (Letër A4) materialeve të ndryshme 12475 faqe
- Fotografimi, publikimi dhe arkivimi fotove për të gjitha aktivitetet në AKSP

## 4. LEGJISLACIONI DHE PLANIFIKIMI STRATEGJIK

### 4.1. LEGJISLACIONI

DÇL gjatë periudhës gjashtë raportuese Janar-Dhjetor 2024, ka përfunduar këto aktivitete në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi si dhe aktiviteteve të parapara në kuadër të planit vjetor të punës si në vijim :

- Hartimi i draft- Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesit në AKSP.
- Hartimi i Udhezuesit (AKSP) Nr. 01/2024 për Përcaktimin e Procedurave Kundër Mashtrimit;
- Miratimi i Rregullore (AKSP) Nr. 02-2024 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në AKSP
- Miratimi i Rregullores KF - Kundër Plagjiaturës në FSP
- Miratimi i përcaktimit të procedurave për hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme në AKSP
- 65 draft vendime që kanë rregulluar dhe përcaktuar fusha dhe procese të ndryshme brenda institucionit;
- Pjesëmarrje dhe udhëheqja e komisioneve të ndryshme (disiplinore dhe të ankesave)
- 8 Shkresa të ndryshme për nevojat e njësi.
- 9 këshillave ligjore dhe konsultime.

- 9 Grupe Punuese pjesëmarrës në për hartimin e dokumenteve të ndryshme
- 31 njoftimet e njësisve organizative në lidhje me aktet e reja normative që lidhën me fushëveprimin e AKSP-së.
- Procedimi dhe kompletimi i lëndëve në avokaturën shtetërore dhe MPB për 12 raste të proceseve gjyqësore si dhe shumë aktivitete tjera sipas kërkesave të njësisve.

#### 4.2. PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Në aspektin e planifikimit strategjik janë hartuar raporte dhe plane vjetore për AKSP-në si dhe është ofruar mbështetje në lidhje me përcaktimin e objektivave dhe prioritetëve të Institucionit.

DPS ka zhvilluar takime dhe diskutime në lidhje me zbatimin e aktiviteteve nga plani punës për vitin 2024 dhe strategjisë së AKSP-së për vitet 2023 – 2026.

- **Hartimi i dokumenteve planifikuese:** Konformë obligimeve dhe kërkesave ligjore të pranuar nga njësit dhe institucionet tjera janë hartuar **plane** të ndryshme për orientimin e aktiviteteve të AKSP-së si vijon:
  - ✓ Plani Vjetor i Punës AKSP 2025
  - ✓ Lista e rreziqeve AKSP 2025
  - ✓ Plani Integritetit AKSP 2024-2026
  - ✓ Draft - Plani i Përformancës AKSP 2025
- **Hartimi i raporteve** - Konformë obligimeve dhe kërkesave të pranuar nga njësit tjera dhe institucionet tjera janë hartuar mbi **22 raporte** të ndryshme për prezantimin e të dhënave dhe aktiviteteve të AKSP-së si vijon:
  - ✓ Raporte / Plane mujore të AKSP-së për MPB;
  - ✓ Raporte mbi të arriturat periodike të AKSP-së,
  - ✓ Raport vjetor i punës për vitin 2023 ,
  - ✓ Plotësimi i raportit vjetor - pyetësorit të kontrollit të menaxhimit financiar të AKSP sipas kriterëve dhe afateve të NJQH-MFPT,
  - ✓ Hartimi i të dhënave nga AKSP për Raportin e KE-së për Kosovën - 2024 për përgatitja e kontributit/inputit ( Pjesa I dhe II ),
  - ✓ Hartimi i Raportit të përformancës së AKSP-së për vitin 2023.
  - ✓ Raporti i Monitorimit dhe Zbatimit të Planit të Integritetit të AKSP-së për periudhën janar-qershor 2024

DPS është angazhuar në të gjitha proceset e Akreditimit vendore dhe ndërkombëtarë të AKSP-së si dhe me proceset tjera që zhvillohen në AKSP.

## 5. SHËRBIMET E PËRGJITHSHME DHE FINANCAT

---

### 5.1. BURIMET NJERZORE

Koordinimi dhe Planifikimi i BNP - Me qëllim të koordinimit për planifikimin e burimeve njerëzore, janë organizuar takime të përbashkëta me udhëheqësit e njësive organizative të Akademisë.

Gjatë periudhës raportuese DBNJ ka arritur të përmbushë detyrat si në vijim:

- Njoftimi, dërgimi dhe Përpilimi i listës për zyrtarët e lartë dhe dërgimi tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.
- Dërgimi i njoftimit për Deklarimin e Dhuratave për vitin 2024.
- Raportimi i rasteve të Konfliktit të Interesit për vitin 2023.
- Përfundimi i Vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për vitin 2023
- Përgatitja e Planit Vjetor të trajnimeve të nëpunësve civil 2024.
- Pas dërgimit dhe trajtimit të Ankesave në DMZP lidhur me ekuivalentimin e koeficienteve të 14 zyrtarëve në AKSP, vetëm 7 prej tyre iu është ngritur koeficienti.

### Rekrutimi - Konkurse

- Konkurs - për pozitën e vendit të punës Roje Sigurimi nga data 01.03.2024 deri më 10.03.2024 (është anuluar)
- Rekrutimi - Konkursi për pozitën e vendit të punës Mjek i Praktikës së Përgjithshme nga data 19.10.2024 deri më 17.11.2024.
- Rekrutimi - Konkursi i shpallur më datën 20.09.2024 deri më 14.10.2024 - Titulli i pozitës Teknik i mirëmbajtjes - Ngrohtore
- Rekrutim - Konkursi i shpallur për pozitën e vendit të punës Zyrtar i Depos nga data 16.02.2024 deri më 16.03.2024
- Rekrutim - Konkursi i shpallur më datën 24.02.2024 deri më 24.03.2024 - Titulli i pozitës Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa
- Rekrutim - Konkursi i shpallur më datën 20.09.2024 deri më 14.10.2024 - Titulli i pozitës Teknik Elektricit
- Plotësim-ndryshimi i katër (4) akt-emërime për avancimin e stafit.

**Pensionim** - 4 zyrtar të pensionuar me moshën e arritur, ku njeri prej tyre me krekës të parashtruar duke filluar nga data **01.05.2024** deri më datën kur plotësohet mosha e pensionimit.

**Dorëheqje** : Gjatë periudhës raportuese janë miratuar **tri kërkesa për dorëheqje nga vendi i punës si vijon:**

- Vendimi nr.152 datë 14.06.2024 miratohet dorëheqja zyrtares nga pozita e punës Asistente Administrativë.
- Vendimi nr.155 datë 28.08.2024 i miratohet dorëheqja e zyrtarit nga pozita e punës Profesor i Asociuar në FSP-AKSP.
- Vendimi nr.161 datë 10.09.2024 i miratohet dorëheqja e zyrtarit nga pozita e punës Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa.

**Transfere të Jashtme:** Zyrtarja e lartë për media me nr.160 të protokollit të datës 15.08.2024 të Marrëveshjes për transferim të përhershëm të nëpunësit Civil nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike transferohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga data 01.09.2024.

**Ndërprerje e marrëdhënies së punës:** Zyrtarit në pozitën Teknik i mirëmbajtjes Ngrohtores në DFSHP me vendimin nr. 165 të protokollit të datës 26.09.2024 i shqiptohet masa disiplinore Ndërprerje e marrëdhënies së punës.

**Pushim pa Pagës** – Gjatë periudhës raportuese janë miratuar dy kërkesa për pushim pa pagesë ( vendimin nr. 201 dhe 202 të datës 16.10.2024 )

**Pushim i Lehonisë** – Gjatë periudhës raportuese është miratuar kërkesa për pushim prindëror të lehonisë (vendimin nr.181 të datës **08.09.2023**)

**Praktikant-** Me vendimin nr. 206 të datës 18.10.2024 miratohet kërkesa për praktikante në Divizionin e Përkrahjes Gjuhësore, pranë AKSP-së nga data 17.10.2024 deri më 16.01.2025.

**Trajnimi i Stafit të AKSP-së** - DBNJ në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive ka identifikuar nevojat për trajnimin e personelit dhe ka përgatitur Planin e Trajnimeve për vitin 2024. Plani i Trajnimeve për stafin e AKSP përveç IKAP implementohet edhe në bashkëpunim me organizata tjera. Gjatë periudhës raportuese janë organizuar shumë trajnime për stafin nga AKSP, KREN, FLSA, SIMFK CEPOL, EFSCA, IOLAR, NCJA ku kanë vijuar trajnime **134 vijues.**

## **5.2. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA**

Po ashtu janë përkrahur të gjitha njësitë me shërbime dhe furnizime të nevojshme si:

- Akomodimin e 20,500 persona.
- Pjesëmarrës në trajnim duke llogaritur në baza ditore 22,500 persona.
- Kujdes shëndetësorë pranë AKSP-së kanë kërkuar gjithsejtë 2531 persona
- Shërbimet e transportit, pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të AKSP
- Arkivimi i Diplomave, Formave dhe Testeve.
- Përgatitja e objekteve për trajnime dhe për aktivitete të ndryshme.
- Furnizim me material shpenzues për zyre etj.
- Ofrimi i shërbimeve të sigurimit të hapësirave të AKSP-së për të gjitha aktivitetet që mbahen dhe organizohen në AKSP.

### 5.3. FINANCAT

Të dhënat statistikore janë të marruara nga Raportet e gjeneruara nga SIMFK si dhe raportet e brendshme financiare.

Tabela e buxhetit, alokimeve si dhe shpenzimeve buxhetore 01.01 – 31.12.2024 (Janar-dhjetor2024)								
Kategoritë ekonomike	Buxheti i Aprovuar	Alokuar	Zotimet	Shpenzuara	Mjete të lira	Buxhet i pa alokuar	Zotime %	Shpenzim %
Paga &Mëditje	1,047,243.30	1,047,243.30	0.00	1,047,243.30	0.00	0.00	0.00	100.00
Mallra Shërbime	1,444,221.00	1,444,221.00	16,134.61	1,411,279.28	16,807.11	0.00	1.12	97.72
Shpen. Komunali	144,030.00	144,030.00	0.00	114,726.02	29,303.98	0.00	0.00	79.65
Shpen. Kapitale	266,000.00	266,000.00	1,927.00	193,814.34	70,258.66	0.00	0.72	72.86
<b>Total</b>	<b>2,901,494.30</b>	<b>2,901,494.30</b>	<b>18,061.61</b>	<b>2,767,062.94</b>	<b>116,369.75</b>	<b>0.00</b>	<b>0.62</b>	<b>95.37</b>

### 5.4. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Në fushën e teknologjisë informative ndër të tjera janë kryer këto aktivitete:

- Zhvillimi dhe implementimi i rregullave dhe procedurave për procedimin e të dhënave elektronike, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të TI-së;
- Administrimi, konfigurimi, menaxhimi dhe monitorimi i Sistemit të Serverëve
- Administrimi i sistemit të video vëzhgimit (Sistemit të vëzhgimit me IP Kamera).
- Administrimi dhe monitorimi i sigurisë së rrjetit në baza ditore nga ndërhyrjet e mundshme (jashtme dhe brendshme)
- Administrimi i sistemit E-Learning në platformën Moodle
- Administrimi i Sistemit të Menaxhimit Universitar (SMU);
- Administrimi dhe menaxhimi me sistemin për mësim online G SUITE për FSP
- Administrimi dhe monitorimi i pajisjeve të sistemit të vijueshmërisë në punë
- Mirëmbajtja e WEB faqes AKSP-së dhe Administrimi i Syslog Serverit.
- Mbikëqyrja dhe menaxhimi i madhësisë së bazave të dhënave si dhe bërja backup (kopje rezervë) të bazave të dhënave.
- Administrimi i sistemit të Serverëve në platformën Linux (Sistemi i telefonisë fikse VOIP, sistemi i tarifimit të telefonisë fikse, sistemi Moodle, softueri për menaxhim të Bibliotekës, etj.)
- Implementimin e projektit për instalimin e kartelave mbrojtëse për qasje në kompjuter për gjithë zyrtarët e AKSP-së
- Administrimi i rrjetave LAN dhe Wireless në Kampusin e AKSP-së.
- Instalimin e sistemit operativ dhe të gjitha programet që janë të nevojshme, vendosjen në domain dhe konfigurimin e llogarisë për të gjitha klasat në ndërtesën kryesore për trajnimin profesional për PK dhe SHKK
- Pjesëmarrja në komisione për hapje dhe vlerësim të tenderëve si dhe në komisione për pranim si dhe menaxher të kontratave.



## 6. SIGURIMI I CILËSISË

---

Në lidhje me përmirësimin e cilësisë dhe obligimeve që dalin karshi planit të punës nga fusha e cilësisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 prezantojmë si në vijim:

- Përmirësimi i vazhdueshëm përmes sigurimit të cilësisë dhe proceset akredituese
- Ngritja e nivelit pjesëmarrës të njësive organizative në proceset e sigurimit të cilësisë me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm
- Plani i aktiviteteve i hartuar dhe adresuar tek Dekani dhe Drejtori i Përgjithshëm AKSP.
- Zhvillimi i takimit me AKA lidhur me planet dhe fazën përgatitore për ri akreditim.
- Konformë doracakut të cilësisë janë zhvilluar pyetësorët për të gjitha aktivitetet e planifikuara të ndara në ato trajnuese dhe të arsimit të lartë.
- Gjithsejtë janë kryer vlerësimin e 28 trajnime nga fushat e ndryshme duke mos numëruar këtu trajnimet profesionale që zhvillohen në AKSP.
- Në koordinim me njësitë e vlerësuara në kuadër të programeve të ofruara është koordinuar në veprim dhe i njëjti është shqyrtuar me akterët relevant.
- Plani i përmirësimit për vitin 2024 është finalizuar
- Me 15.01.2024 ka dorëzuar aplikacionin për procesin e ri akreditimit nga IADLEST.
- Me date 27.02.2024 ka filluar procesi zyrtar i ri akreditimit dhe AKSP ka filluar ngarkimin e dokumenteve pranë komisionit vlerësues ndërkombëtar për fazën e veprimit.
- Gjerë me datë 30.03.2024 ka ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara, ka pranuar vlerësim dhe ka zhvilluar takime me komisionin i cili për fazën e veprimit ka vlerësuar AKSP me 140 pike, ose 4 pike me shume se në vlerësimin e vitit 2021.
- Me datë 23.05.2024 është zhvilluar takimi i përgjithshëm dhe i përbashkët me akterët sipas standardeve të ri-akreditimit ndërkombëtar nga IADLEST.
- Me datë 18-19.11.2024 në AKSP ka qëndruar ekipi vlerësues i ekspertëve nga IADLEST i cili pas periudhës verifikuese ka rezultuar me sukses ky proces ku AKSP është Ri-akredituar me çmimin e ekselencës. Jemi në pritje të kalimit formal të vendimit përmes Komitetit të IADLEST.
- Me datë 15.10.2024 u themelua grupi punues për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit për IAAP. Pas një pune intensive, me datë 09.12.2024 miratohet RVV dhe i njëjti adresohet tek AKK, MASHT dhe KAAPR
- Me datë 10.12.2024 me vendimin nr. 243 u themelua Komisioni për Sigurimin e Cilësisë KSC. Si pjesë e pakos së parë rishikuese me date 23.12.2024 është adresuar Doracaku i Sigurimit të cilësisë dhe politikat e implementimit të modelit Kirkpatrick (niveli 3 dhe 4 i sistemit).

## **6.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË (AKK, AKA, IADLEST)**

### **AKA-Agjencia Kosovare e Akreditimit**

- DSC ka zhvilluar planin dinamik te veprimet dhe ka ofruar raportin e qëndrueshmërisë se arsimit te larte ne AKSP bazuar në pyetësorin e adresuar tek studentët dhe palët e interesit, raporti dhe analiza e të gjeturave sipas informatës kthyesë është adresuar tek FSP, bazuar ne te cilin është hartuar edhe plani për veprim, i njëjti i adresuar tek FSP.
- DSC ka zhvilluar takim me ZDP dhe FSP lidhur me procesin akreditues.
- Me datë 17.07.2024 Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike morri vendim me nr. 124/02 për pezullimin e aplikimit të AKSP për nënshtrim të procesit akreditues për vitin 2024, i njëjti u adresua tek AKA.

### **AKK-Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve**

- AKSP gjatë gjithë periudhë nga data 15.01.2024 deri me 18.06.2024 ka adresuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas kërkesave nga Këshilli Drejtues i AKK në formatin elektronik dhe fizik
- Me datë 04.09.2024, KD i AKK ka miratuar aplikacionin e AKSP për procesin e ri-akreditimit dhe rivalidimit.
- Me datë 03.10.2024 zyrtarisht kemi adresuar kërkesë tek AKK për përshpejtim të procesit vlerësues të AKSP.
- Me date 24.12.2024 kemi zhvilluar takimin e fundit për vitin 2024 me AKK në formatin digjital dhe jemi njoftuar për ndryshimet e reja në menaxhimin e proceseve akredituese aktuale për të cilat neve jemi ne pritje.

### **IADLEST**

Sa i përket rekomandimeve nga IADLEST, janë adresuar nevojat për rishikim të politikave tek njësitë me te cilat kemi zhvilluar një mori takimesh.

Po ashtu janë draftuar 5 politika të tjera shtesë sipas standardeve te akreditimit.

Me datë 23.05.2024 është zhvilluar takimi i përgjithshëm dhe i përbashkët me akterët sipas standardeve të ri-akreditimit ndërkombëtar nga IADLEST. Pas kësaj date kanë pasur takime ndaras me njësitë relevante dhe janë vizituar disa nga pikat e referimit të raportit të EE të IADLEST nga vitit 2021.

Me datë 30.05.2024 është përmbyllur faza e ngarkimit të dokumenteve dhe vlerësimit preliminar nga komiteti i IADLEST.

Me datë 18-19.11.2024 në AKSP ka qëndruar ekipi vlerësues i ekspertëve nga IADLEST i cili pas periudhës verifikuese ka rezultuar me sukses, ku AKSP është Ri-akredituar me çmimin e ekselencës. Jemi ne pritje te kalimit formal të vendimit përmes Komitetit të IADLEST.

## 6.2. VLERËSIMI I TRAJNIMEVE

DSC-ja sipas planifikimit të realizimit të trajnimeve në AKSP për periudhën janar – dhjetor 2024 ka bërë vlerësimin e 36 trajnimeve, ku mesatarja e kalueshmërisë është 91.81 % sipas agjencioneve në tabelë:

2024	PK	AKSP	AME	OSBE	SHKK	GJITHSEJ
Nr. i kurseve	17	7	9	2	1	36
Mesatarja e kalueshmërisë në %	86.33%	90.79%	93.78%	90.79%	97.40%	91.81 %

## 6.3. AKTIVITETET DHE GJENDJA AKTUALE

DSC-ja në kuadër të aktiviteteve që kanë shënuar këtë periudhë kohore Janar-Dhjetor 2024 ka realizuar vlerësime të politikave të sigurimit të cilësisë dhe bazuar në planin e punës ka adresuar nevojën për rishikim të disa udhëzimeve dhe procedurave të cilat në raste ekstreme mungojnë apo nuk janë rishikuar qysh nga viti 2012.

Vlen të theksohet edhe vizita/trajnimi i realizuar në NCJA-SHBA me ç’rast pjesëmarrësit e tri ISP-ve dhe zyrtar të AKSP u trajnuan në fushën e sigurimit të cilësisë.

Po ashtu theks të veçantë i është kushtuar fazës përgatitore për implementimin e trajnimeve të rivaliduara dhe implementimit të rekomandimeve nga AKA, AKK dhe IADLEST. Proceset e riakreditimit ndërkombëtar janë ato të cilat e shënojnë vitin 2024.

## 7. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

### 7.1. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Më 14 shkurt 2024 në AKSP u prit në vizitë Drejtori i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë në MPJD në Kosovë, me ç’rast u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet AKSP-së dhe Departamentit përkatës të MPJD-së.

Më 7 maj 2024 në AKSP u mbajt tryezë me temën “Rendi i ri botëror dhe siguria kombëtare” nga Shoqata e Pensionistëve të TMK/FSK dhe Simpatizantëve “ELITA” në kuadër të javës së sigurisë, ku u diskutua gjendja e sigurisë në vend. Në kuadër të saj ka qenë edhe një prezantim për rolin dhe rëndësinë e AKSP-së në sigurinë publike në Kosovë.

Më 31 korrik 2024, një delegacion i AKSP-së, vizituan Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim Shpëtim (QNTKSH) të FSK-së. Qëllimi i vizitës ishte njohja me rolin

dhe aktivitetet e QNTKSH-së në trajnimin e FSK-së, me fokus në emergjencat, si dhe shqyrtimi i mundësive për konkretizimin e marrëveshjes ekzistuese ndërmjet dy institucioneve.

Nga 11 - 13 shtator 2024, përfaqësuesi nga DMJ mori pjesë në Punëtorinë për hartimin e Strategjisë së Komunikimit dhe Planit të Veprimit të MPB-së 2025-2025. Në punëtori ishin të pranishëm përfaqësues nga MPB, IPK, AME, si dhe ekspertë nga Misioni i OSBE-së dhe Projekti i BE-së HAPE, i cili financoi ngjarjen.

**Bashkëpunimi me Zyrën e Kryeministrit (ZKM), respektivisht Zyra e Qeverisjes së Mirë.** Pjesëmarrja në punëtori për rishikimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 / hartimi i planit të rishikuar të veprimit 2025-2026.

AKSP ka përkrahur Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) përmes mirëpritjes në AKSP të pjesëmarrësve të vizitës studimore-shkëmbim përvojash nga shtetet e rajonit Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi nga 02 - 04.12.2024.

## **7.2. BASHKËPUNIMI ME PARTNER NDËRKOMBËTAR BRENDA VENDIT**

**Erasmus+:** Më 11 janar 2024 në AKSP u zhvillua Dita e informimit të Erasmus+ për AKSP, ku delegacioni i Zyrës së Erasmus+ në Kosovë udhëhiqej nga Koordinatorja e kësaj Zyre, Mimika Dobrosi.

AKSP nënshkroi për herë të parë Marrëveshje Ndër-Institucionale përmes Erasmus+ me Fakultetin të Sigurisë në Shkup të Universitetit St. Kliment Ohridski të Manastirit, Maqedoni e Veriut, në bazë të së cilës gjatë majit 2024 u arritën që të shkëmbehen nga 2 mësimdhënës nga secili institucion, pra gjithsej 4 duke përfshirë dhe dekanët e të dyja Fakulteteve përkatës. Është i planifikuar edhe një shkëmbim (mobilitet) me kredi (për një semestër) për një student të FSP të AKSP.

**Misioni i Zbatimit të Ligjit në Kosovë (EULEX):** Më 30 maj 2024 një delegacion i përbërë nga 4 zyrtarë policorë, 2 nga Holanda dhe 2 Suedia, kanë bërë një vizitë në AKSP dhe janë interesuar për trajnimet në fushën e policimit në bashkësi që ofrohen në AKSP.

**Institucionet dhe mekanizmat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) të pranishme në Kosovë**

**Zyra në Evropë e Agjencisë së Mbrojtjes të Zvogëlimit të Kërcënimit (Defense Threat Reduction Agency) të SHBA-ve.-** Me 4 qershor 2024, ky mekanizëm i koordinuar nga prania e SHBA-ve në Kosovë, në bashkëpunim edhe me pjesëmarrje edhe të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Policisë së Kosovës (PK), organizuan dhe mbajtën në AKSP skenarin e koordinimit ndër-institucional në terren për luftimin e armëve të shkatërrimit në masë (IA CWMD FTX).

**Ambasada e SHBA-ve në Kosovë** - Më 6 qershor 2024, një delegacion i AKSP-së pati një takim me Këshilltarin e Lartë për Zbatimin e Ligjit dhe Korrektues (KLZLK) në këtë Ambasadë.

**KFOR**- Më 5 qershor 2024 në AKSP u mirëpritën 2 (dy) zyrtarë të kontingjentit hungarez të KFOR-it. Më 6 qershor 2024, ndërmjetësuar dhe me praninë edhe të zyrtarëve të lartë nga Misioni në Kosovë i OSBE-së, në AKSP qëndroi një vizitë një delegacion nga Ekipi Këshillues Ndërlidhës i NATO-s (NALT), me të cilët u diskutua për përkrahje në trajnimet specifike mbi armët e zjarrit dhe ndihmën e parë.

### **7.3. BASHKËPUNIMI ME ASOCIACIONE DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE**

**Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatimin e Ligjit (CEPOL):** Nga 30 - 31 janar 2024, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së mori pjesë në Forumin e Përbashkët të Bashkëpunimit Strategjik të CEPOL dhe EUROPOL, i cili u mbajt në Hagë, Holandë. Përveç tij, në këtë takim nga Kosova mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Programi i Shkëmbimit të CEPOL: Deri më 01.03.2024 ka qenë afati për aplikim për programin e shkëmbimit (CEPOL EP 2024) dhe përkundër ftesave të dërguara tek të gjitha institucionet përkatëse të zbatimit të ligjit në Kosovë (PK, DK, AKF, NJIF, ATK, KGJK), ku për këtë vit kemi vetëm 2 kërkesa/aplikime që janë bërë nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë (AKF) ndërsa institucionet tjera nuk kanë parashtruar kërkesa.

Nga 3 - 4 qershor 2024 një punonjës i AKSP-së mori pjesë në Javën e Hulumtuesve të Rinj të CEPOL, e cila u mbajt në Budapest, Hungari.

Gjatë periudhës 12 - 17.05.2024, z. Labinot Mazreku nga AKF ka përfunduar me sukses mobilitetin e tij (shkëmbimin) në Shqipëri përmes CEPOL

**Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit (IADLEST):-** Nga 2 - 5 qershor 2024 Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së mori pjesë në Konferencën Vjetore të 2024 të IADLEST, e cila u mbajt në Phoenix, Arizona, SHBA. Asociacionit të Kolegjeve Evropiane të Shërbimit të Zjarrëfikjes (EFSCA): Nga 11-12.06.2024 nga AKSP morën pjesë 3 (tre) zyrtarë nga niveli i Menaxhmentit të AKSP-së në takim vjetor dhe konferencën vjetore të EFSCA e cila u mbajt në Varshavë (Warsaw) në Poloni.

### **7.4. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË NDRYSHME JASHTË VENDIT**

**Maqedonia Veriore** - Me datë 14.03.2024, jemi njoftuar nga Fakulteti i Sigurisë nga Maqedonia e Veriut se projekti i përbashkët në kuadër të Erasmus+ për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve është miratuar nga fondi i programit Erasmus+.

Në tërësi janë 3 mobilitete nga AKSP për në FS të MV (1 student për studime për një semestër dhe 2 mësimdhënës/ligjërues) si dhe 2 mobilitete nga FS i MV në AKSP (2 mësimdhënës /ligjërues). Realizueshmëria e mobiliteteve duhet të përfundoj brenda periudhës 2024 - Qershor 2025.

**Mali i Zi:** Nga 2 - 5 dhjetor 2024, në bashkërendim me MPB-në dhe PK-në, me kërkesë të tyre një ekip nga Policia Komunale e Komunës së Ulqinit (PKKU) Mali i Zi qëndruan në AKSP, ku zhvilluan aktivitete nga fusha e zbatimit të ligjit në AKSP dhe PK- Prishtinë.

**Belgjika:** Më 12 mars 2024 në AKSP erdhën për vizitë Pedro Fioen dhe Bram Lembrechts nga Universiteti Vives i Shkencave të Aplikuara nga Belgjika, me të cilët akorduan që të shqyrtohen mundësitë për bashkëpunim të ndërsjellët ndërmjet Departamentit të Sigurisë të këtij Universiteti dhe Fakultetit të Sigurisë Publike të AKSP-së.

**Bullgaria:** Më 20 shkurt 2024 në AKSP u zhvillua një vizitë nga një delegacion i MPB të Bullgarisë, udhëhequr nga Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme në Republikën e Bullgarisë Ivelina Dundakova. Delegacioni u shoqërua edhe nga Zv. Ministri i MPB të Kosovës, Bardhyl Dobra. Në vizitë ishte i pranishëm edhe Simo Mihov, Zëvendës rektor i Akademisë së MPB të Bullgarisë, i cili u zotua se do të kontribuojë në ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet AKSP-së dhe institucionit prej nga ai vjen.

**Gjermania:** Nga 18 - 22 mars 2024, 2 studentë të Fakultetit të Sigurisë Publike (FSP) të AKSP-së morën pjesë në Javën vizituese për studentët ndërkombëtarë, e cila u mbajt në Akademinë Policore të Saksonisë së Ulët në Gjermani. Qëllimi i këtij aktiviteti është sjellja së bashku e studentëve nga institucionet e ndryshme të trajnimit policor në Evropë.

**Norvegjia:** Nga 15 - 19 prill 2024, 1 (një) student i Fakultetit të Sigurisë Publike të AKSP-profilu Policisë mori pjesë në Javën Ndërkombëtare të Studentëve për Policimin digjital, e cila u mbajt nga 14 - 19 prill 2024 (pa i përfshirë ditët e udhëtimit) në kampusin në Stavern afër Oslos të Kolegjit Universitar Policor të Norvegjisë në Norvegji.

**Estonia:** Nga 7 - 11 maj 2024, Udhëheqësi i DMJ në AKSP vizitoi zyrtarë të fushës së bashkëpunimit ndërkombëtar në Akademinë e Estonisë të Shkencave të Sigurisë në Tallinn me qëllim të mundësisë së vazhdimit të bashkëpunimit me këtë institucion partner.

**SHBA:** Më 4 tetor 2024 AKSP ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Akademinë e Drejtësisë të Karolinës së Veriut (NCJA) -SHBA në selinë e AKSP-së në Vushtrri, Kosovë. Duhet theksuar se për nënshkrimin e kësaj marrëveshje, mbulimi i të gjitha shpenzimeve për ardhjen dhe akomodimin e përfaqësuesit të NCJA, u bë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Kësaj Marrëveshje në vitin 2024 i ka paraprirë një vizitë nga 27 - 31 maj 2024, kur një delegacion nga AKSP, i shoqëruar edhe me nga një zyrtar nga

PK, SHKK e IPK si dhe dy zyrtarë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, qëndruan për një vizitë studimore për çështje të sigurimit të cilësisë në Akademinë e Drejtësisë të Karolinës Veriore në SHBA.

Shërbimi Pyjor i SHBA-ve (USFS) kanë mbajtur për herë të parë në AKSP trajnimin themelor për Sistemin e Komandës së Incidentit (SKI) për gjithsej 19 pjesëmarrës, dhe atë 14 nga Njësitë e zjarrfikës të AME-së dhe 5 të tjerë nga Njësia e Emergjencës e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Mitrovicë. Ky trajnim është njëri prej disa trajnimeve të tjera të avancuara që do të mbahen në AKSP në kuadër të projektit të përbashkët të USFS, AKSP-së dhe AME-së që do të mbahen gjatë periudhës kohore 2024-2026.

## **8. KOMUNIKIMI DHE MEDIA**

---

Me qëllim të promovimit të vlerave, ngritjes së imazhit dhe transparencës Institucionale gjatë kësaj periudhe të gjitha zhvillimet dhe aktivitetet që mbahen në Akademi bëhen transparente në forma të ndryshme duke i publikuar në portale, rrjete sociale e po ashtu edhe në radio dhe televizione. Në lidhje me këtë, gjatë kësaj periudhe raportuese në ueb-faqen e AKSP-së, portale elektronike informative, televizione, radio, gazeta, revistat vendore janë publikuar **34** informata, lajme, ngjarje dhe aktivitete si dhe janë publikuar 47 dokumente. Zyra e Mediave përcjell aktivitetet e të gjitha Institucioneve të cilat ndërlihen me AKSP-në. Zyra e Mediave ka mbajtur aktive ueb-faqen e AKSP-së, faqen e Fakultetit të Sigurisë si dhe rrjetin sociale, siç është FACEBOOK, duke plasuar të gjitha informatat nga aktivitetet që janë mbajtur në AKSP si dhe ka pasuruar atë konformë kërkesave dhe projekteve të Akademisë.

## **9. AUDITIMI**

---

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të auditimit që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë.

✚ **Auditimi Jashtëm** – Gjatë muajit qershor 2024 është publikuar raporti i auditimit të jashtëm ZKA për MPB - AKSP ku ne si Institucion **kemi pranuar vetëm 1 rekomandim sipas procesit të auditimit për vitin 2023 ku i njëjti tashmë është adresuar.**

- Auditimi i brendshëm** - Sipas planifikimit të auditimit për vitin 2024, Divizioni Auditimit të Brendshëm /DAB ka përfunduar si procese auditues si vijon:
- Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përbashkëta/ DFSHP
  - Fakultetin e Sigurisë Publike /FSP
  - Divizionin për Buxhet dhe Financa
  - Proces në MPB – ku Auditori Brendshëm ka qenë i angazhuar gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2024 në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) për ofrimin e shërbimit të këshillëdhënies

Për të gjitha proceset audituese janë hartuar dhe adresuar raportet me rekomandime konkrete.

## 10. PROKURIMI

Duke u bazuar në Planin e Divizionit të Prokurimit për vitin 2024, AKSP ka planifikuar 28 aktivitete të prokurimit sipas planit të dorëzuar në ZKA- AKSP dhe AQP për realizim ashtu siç obligohet me aktet ligjore për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2024 Divizioni i Prokurimit, ka zhvilluar 31 aktivitete -procedura prokurimi prej tyre:

- 26 aktivitete nënshkuara
- 2 aktivitete të anuluar
- 2 aktivitete në proces/vlerësim
- 1 aktivitet në shqyrtim OSHP

